



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:008257

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05764586

P.nr.2356/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit: D. (A.) P. nga fshati Cermjan K. Gjakovës, për shkak dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale:shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.3825/15 të datës 01.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Shahadin Destani, i akuzuari D.P., me mbrojtësin av. Blend Gjini, me datë 15.05.2024, vendosi dhe të njëjtën ditë publikisht, në prezencë të të gjithë palëve, shpalli, ndërsa me datën 30.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D.P., nga i ati, e ëmae lindur, i lindur menë fshatin Cermjan Komuna e Gjakovës, ka të kryer shkollën e mesme, i divorcuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit

ËSHTË FAJTOR

- I. Me datë 11.12.2015, në pikën kufitare Vërmicë, me automjetin e tij „ Be....., me Targa të regjistrimit, i akuzuari merr veprime të rrezikshme duke shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve si dhe dëme të konsiderueshme pasurore i cili me shpejtësi ishte ofruar pikës kufitare në Vërmicë, korsi nr.2 e cila ishte e mbyllur edhe pse rreshteri policor A.L., e kishte sinjalizuar, por i akuzuari nuk e kishte respektuar shenjën dhe kishte goditur kohën e vendosur në mes të korsive, po ashtu e kishte goditur edhe konen e dytë si dhe laurën e cila e mbyllur, dhe me shpejtësi largohet nga pika doganore Vërmicë duke u futur në autostradë në drejtim të Prizrenit, ku në afërsi të „, saktësisht rreth orës 14.00, është kapur nga organet policore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: shkatim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082,

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 8, 9, 17, 41, 42, 49, 46, 49, 50, 51, 52, 53, 73, 74, 75 të KPRK-së, nr.04/L-082 dhe neni 364 të KPPK-së.

Të akuzuarit D.P., i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

- Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- Në qoftë se i akuzuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet i njëjti do të revokohet.
- I dëmtuari me adresë si në shkresat e lëndës për realizimi e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil-juridik.
- OBLIGOHET i akuzuari D.P., që ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej (20) njëzet euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej (20) njëzet euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.
- Urdhërohet Shërbimi Sprovues i Kosovës - dega në Prizren, që të bëjë mbikëqyrjen e dënimit me kusht.

Në bazë të nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPP-së

REFUZOHET AKTAKUZA

- II. Në kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I të kësaj aktakuze, i akuzuari me automjetin e tij me shënime si në dispozitivin nën I të kësaj aktakuze e sulmon personin zyrtar, rreshterin policor tani të dëmtuarin A.L., i cili ishte në kontrollë zyrtar në pikën kufitare në Vërmicë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe ruajtjen e rendit publik, lidhur me sigurinë e përgjithshme të vendit.

Kësodore kishte për të kryer veprën penale: sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 para.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082.

- për arsye të parashkrimit absolut (**ndalesa absolute e ndjekjes penale**), parashkrimi ka arritur me datë 11.12.2021.
- III. Po ashtu në vend dhe kohë të njëjtte të përshkruar si në dispozitivin nën I të kësaj aktakuze i akuzuari asgjëson, dëmton duke bërë të papërdorshëm pasurinë dhe atë laurën e cila ishte e mbyllur në pikën kufitare Vërmicë në korsin numër dy, në rrethana të përshkruara si në dispozitivin nën I dhe II të kësaj aktakuze, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale.

Kësodore kishte për të kryer veprën penale: asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 para.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082.

- për arsye të parashkrimit absolut (**ndalesa absolute e ndjekjes penale**), parashkrimi ka arritur me datë 11.12.2019.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr. 3825/15 të datës 01.11.2016, kundër të akuzuarit D.P., nga fshati Cermjan K. Gjakovës, për shkak dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale:shkatim I rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar më datë 15.05.2024, në të cilin seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe konform dispozitave të nenit 241 e 242 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

I akuzuari deklaron se: e ka të qartë aktakuzën dhe e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurit deklaron se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit deklaroi se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë

Palët heqën dorë nga seanca mbi caktimin e dënimit.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- I. Me datë 11.12.2015, në pikën kufitare Vërmicë, me automjetin e tij „ BenzE320,, me Targa të regjistrimit 07-162-BN, i akuzuari merr veprime të rrezikshme duke shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve si dhe dëme të konsiderueshme pasurore i cili me shpejtësi ishte ofruar pikës kufitare në Vërmicë, korsi nr.2 e cila ishte e mbyllur edhe pse rreshteri policor A.L., e kishte sinjalizuar, por i akuzuari nuk e kishte respektuar shenjën dhe kishte goditur kohën e vendosur në mes të korsive, po ashtu e kishte goditur edhe konen e dytë si dhe laurën e cila e mbyllur, dhe me shpejtësi largohet nga pika doganore Vërmicë duke u futur në autostradë në drejtim të Prizrenit, ku në afërsi të „, saktësisht rrethe orës 14.00, është kapur nga organet policore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë prej të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 251 të KPPK-së.

Gjithashtu, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 240 lidhur me neni 242 të KPPK-së, dhe se në veprimet e të akuzuarit, formohen të gjitha elementet e veprës penale: shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73, 74, 72 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsërisin veprime të tilla kundërligjore. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë, veprën penale të kryer, niveli i dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkallën e lartë të dashjes, ku i akuzuari me dashje, merr veprime të rrezikshme duke shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve si dhe dëme të konsiderueshme pasurore i cili me shpejtësi ishte ofruar pikës kufitare në Vermicë, korsi nr.2 e cila ishte e mbyllur edhe pse rreshteri policor A.L., e kishte sinjalizuar, por i akuzuari nuk e kishte respektuar shenjën dhe kishte goditur kohën e vendosur në mes të korsive, po ashtu e kishte goditur edhe konen e dytë si dhe laurën e cila e mbyllur, andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me këtë masë sanksionuese do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla kundërligjore. Ndërsa për veprat penale **sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 para.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082. Dhe veprës penale, asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 para.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK-së Nr.04/L-082.** Andaj, është konstatuar se për këto vepra penale ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale bazuar në nenin 106 par.1 nën par. 1.5 të KPK-së.

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPK-së i cili konsiston në *“parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimit për respektimin e ligjit”*.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).
- Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 462 par. 1. dhe 2. të KPPRK-së.
- Vendimi mbi kompensimin e viktimave të Krimin, gjykata e mori në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109. ku thuhet “*për veprën penale që gjykohej në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro*”.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2356/16, të datës 30.05.2024

B. Profesionale,
Afërdita Kicaj

Gjyqtari,
Lulzim Hoxha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:008257
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05764586